

B I B L I O G R A F I

PALOK DAKA

KONTRIBUT PËR BIBLIOGRAFINË E GJUHËSISË SHQIPTARE (I)
PARATHANIE

I.

Në Konferencën e parë të Studimeve Albanologjike, që u mbajt në Tiranë, në nandorin e vjetit 1962, u theksue, ndër të tjera, se një nga detyrat kryesore të kuadrove tona shkencore, asht vazhdimi dhe thellimi i matejshëm i punës kërkimore dhe i studimeve shkencore në fushën e albanistikës, në mënyrë që këto studime t'i përgjigjen si duhet nivelit që kërkon dija e kohës sonë. Për plotësimin e kësaj detyre, një rol të randësishëm në përvetësimin e njohunive teorike e praktike, në njohjen e përpjekjeve dhe të rezultateve të arrituna në fusha të ndryshme të ditunive, luen pa dyshim edhe bibliografia. Madje bibliografia, si një disiplinë shkencore më vechte, asht ba një udhëtrgues i domosdoshëm për të gjithë ata që merren ose duen të merren me studime shkencore, sepse "zhvillimi i sotëm dhe i nesërm i shkencave albanologjike nuk mund të kuptohet pa pasur parasysh burimet dhe rrugët e tyre të djeshme"¹⁾.

Gjuhësisë shqiptare, — dhe jo vetëm gjuhësisë, — i mungon sot një bibliografi e plotë shkencore. Sprovat dhe kontributet bibliografike për gjuhësinë, që janë botue deri më sot (për to do të flasim ma poshtë), me gjithë shërbimin e çmueshëm që i kanë sjellë studjuesve të ndryshëm, ato, në gjendjen e tyre të sotme, nuk i plotësojnë si duhet dhe sa duhet kërkesat tona; sepse diša nga botimet e përparëshme, ose janë zhdukun nga qarkullimi ose janë ba kopje aq të rralla, sa mezi gjinden në ndonjë bibliotekë a person privat. Veçan, për studjuesin e ri, puna bahet edhe ma e vështirë nga shkaku i kritereve të ndryshme që kanë ndjekun autorët e tyre dhe i gjuhëve të huaja, me të cilat janë shkruet.

Asht pranue nga të gjithë se hartimi i një bibliografie, qoftë edhe e shkurtën, për bibliografin paraqet vështirësi të ndryshme. Vështirësitë bahen edhe ma të mëdha, kur asht fjala për bibliografin retrospektive, sepse atëherë ke të bash me botime të vjetra e të rralla, të cilat asht zor, në mos e pamundun, t'i kalosh të gjitha nëpër duer.

Megjithatë, në mos e plotë, për afërsisht e plotë, një bibliografi e gjuhësisë shqiptare mund edhe të bahet. Natyrisht një punë e tillë kërkon bashkëpunimin e diša bibliografëve, të cilët duhet të gjurmojnë në durim (në plan kronologjik) pasqyrimin në shtyp të mendimit gjuhësor, në etapa e çfaqje të veçanta.

Si bazë kronologjike për hartimin e bibliografisë mund të shërbejë fare mirë ndamja në tri etapa që iu ba, në Konferencën e Studimeve Albanologjike, zhvillimit të shkencave albanologjike, si shkenca mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët. Të tri etapat paraqiten në këtë mënyrë: *etapa e parë*, përfshin periudhën prej kohëve ma të hershme deri në mesin e shek. XIX, *etapa e dytë*, nis nga gjysma e dytë e shek. XIX dhe vazhdon deri në çlirimin e Shqipnisë (1944), *etapa e tretë*, që nga çlirimi i Shqipnisë e këndej. Secila etapë ka karakteristikat e veta dalluese²⁾. Ma të ngjeshuna dhe me problematikë ma të pasun, paraqiten dy etapat e fundit. Si çfaqje kryesore mbi të cilat mund të hartohet bibliografia, na dalin: 1) botimet e veprave në gjuhën shqipe, 2) botimet e veprave në gjuhë të huë (autorët e huë), 3) shtypi shqiptar (dhe ai që i kushtohet ekskluzivisht çështjeve shqiptare (gjuhësore), 4) shtypi i huë.

Bashkërendimi dhe përmbledhja e këtyne tri etapave dhe çfaqjeve do të na jepte veprën e dishrueme.

II.

Ma nalt thamë se gjuhësisë shqiptare i mungon një bibliografi shkencore. Dhe kjo asht e vërtetë. Po nuk mund të pohohet se nuk asht ba asgja. Përkundrazi mjaft dijetarë e studjues të nderuem, shqiptarë e të huë, kush ma pak e kush ma shumë, u muerën, bashkë me trajtimin e çështjeve të tjera, edhe më çështje të bibliografisë gjuhësore.

Me sa dihet, i pari punim bibliografik për gjuhësinë shqiptare, u botue në Vjenë, më 1870, nga dijetari Franc Miklosiç³⁾, në veprën e tij të vlerët *Elementet sllave në gjuhën shqipe*⁴⁾. Këtë punim e ndoqën ma vonë edhe mjaft vepra bibliografike të përgjithshme, pasqyra biblio-

grafike e shtojca me vlera të ndryshme. Nga sa mundëm të hetojmë në fondet e Bibliotekës Kombëtare dhe të Bibliotekës shkencore të U.S.H.T., për të dy etapat e para (deri më 1944), veç Mikloçiqit që përmendëm ma nalt, bibliografi me interes edhe për gjuhësinë kanë shkruar, simbas kronologjisë së botimeve, edhe këta autorë: E. Kupitori, *Studime shqiptare — Trajtim historik dhe filologjik mbi gjuhën dhe kombin e Shqiptarëve*, Athinë, 1879⁵⁾; Gustav Majer, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, "Bibliografi shqipe", Shttrasburg, 1891⁶⁾; F. Manek — Gj. Pekmezi — A. Stotz, *Bibliografi shqipe*, Vjenë 1909⁷⁾; Emil Legrand, *Bibliografi shqipe*, Paris, 1912⁸⁾; Holger Pedersen, *Gjuha shqipe 1909-1912*, Erlangen, 1914⁹⁾; Albert Tumb, *Vjetari indogjerman*, etj. Shttrasburg 1914-1916.¹⁰⁾; Norbert Jokli, *Vjetari indogjerman* etj. Shttrasburg, Berlin, Lajpzig, 1917-1940¹¹⁾; Ludvig Byrhnner, *Sprovë bibliografike të atyne që janë botue rreth Epirit gjatë kohëve ma të reja në "Kronikat Epirote"*, Janinë, 1926¹²⁾ (Lumo Skendo), *Bibliografi shqiptare*, Tiranë, 1926-1929¹³⁾; Perikli Vizukides, *Kontribute në bibliografinë epirote*, Janinë, 1927-1928¹⁴⁾; Nikos Bees, *Kontribute në bibliografinë epirote*, Janinë, 1927¹⁵⁾; D. Kalogeropoulos, *Kontribut bibliografik për çështje shqiptare (1771-1929)*, Athinë, 1929¹⁶⁾; Evlogji Kurilla, *Bibliografia e Epirit dhe e Shqipnisë*, Janinë, 1928-1931¹⁷⁾; Vasil Mystakides, *Kontribut në bibliografinë epirote*, Janinë, 1931¹⁸⁾; Geatano Petrota, *Sprovë e bibliografisë shqipe (1500-1930)*, Palermo, 1931¹⁹⁾; F. Mihalopoulos, *Kontribut në bibliografinë epirote*, Janinë, 1932²⁰⁾; Leon Savadjian, *Bibliografi ballkanike*, — *Shqipnia*, — Paris, 1934-38²¹⁾; Zhan G. Kersopoulos, *Bibliografi Nr. 1, Shqipni*, Athinë, 1934-1938²²⁾; Shalva Beridze, *Bibliografia Franceze e Shqipnisë*, Napoli, 1937²³⁾; Hanri Gysis, *Bibliografi shqiptare*, Tiranë, 1938²⁴⁾; Karlo Taljavini, *Vjetari indogjerman*, etj., Berlin, 1942 dhe *Rrjeshtime bibliografike "Gjuhësi"*, Romë, 1940-1942²⁵⁾; Piero Kosta, *Bibliografi Shqipe*, Tiranë, 1942²⁶⁾. Veç këtyne, si shtesa a punime të vogla shkruene edhe Dr. G. Shtadtmyler, M. Peta, H. Bariç, P. Skok, Ç. Truhelka, e ndonjë edhe pa firmë²⁷⁾.

Mbi të gjithë këta, përsa i përket kontributit bibliografik për gjuhësinë, shquhet N. Jokli, i cili për 23 vjet me radhë bani, me mprehtësi prej shkencëtarit, një varg analizash të hollësishme dhe shënime kritike shumë të çmueshme për vepra e artikuj, që dolën gjatë kohës që ai drejtoi seksionin VII. *Shqipnia* të "Vjetarit indogjerman". Mbas Joklit dhe në vazhdim të punës së tij, megjithëse për një periudhë fare të shkurtën, dallohet për analiza dhe shënime kritike edhe K. Taljavini.

Përmbledhtazi ky asht trashigimi bibliografik kryesor për gjuhësinë. Po që të kemi një bibliografi të plotë, do ende shumë punë.

III.

Nësa për veprat albanologjike (shqipe dhe të hueja), të botueme deri në çlirimin e Shqipnisë, mund të pohohet se janë ba relativisht mjaft botime bibliografike (shih edhe shënimet 3-27), për shkrimet e botueme nëpër gazetat dhe të përkohëshmet nuk mund të thuhet po ajo gja. Dhe me të vërtetë shumë shkrime (artikuj, studime, vëzhgime, vërejtje, materiale të mbledhuna e të dhana të tjera) me randësi jo vetëm për gjuhësinë, kanë qenë — dhe janë — të shpërndame nëpër gazeta e revista të ndryshme. Shumë nga këto organe sot janë ba mjaft të rralla dhe ndonjenit prej tyne nuk i dihet as ekzistenca.

Ky punim mbështetet kryesisht në të dhanat e shtypit shqiptar (dhe të ndonjë reviste të huej, kushtue eskluzivisht çështjeve shqiptare²⁸⁾, që u botuene kohë më kohë që nga gjysma e dytë e shek. XIX e deri në çlirimin e vendit. Shoqnitë kulturele e patriotike të vendit e të mërgimit, komitetet, klubet, organizatat (fetare dhe politike), institucionet shtetnore e personat private, nxorën gjatë kësaj periudhe në qytete të ndryshme të Shqipnisë dhe në vende të hueja (Angli, Argjentinë, Austri, Belgjikë, Bullgari, Egjipt, Francë, Greçi, Indi, Itali, Jugosllavi, Rumani, S.H.B.A., Turqi, etj.) një mori gazetash, revistash, buletinesh, kalendaresh, etj. (shqip dhe në gjuhë të hueja), numuri i saktë i të cilave nuk dihet me siguri as sot²⁹⁾. Disa organe, për shkaqe financiare a politike, u mbyllën që në numurin e parë të daljes së tyne; të tjera u detyruen, po nga këto rrethana, ose nga të tjera, të ndryshojnë disa herë me radhë emnin e organit dhe vendin e botimit. Një arësye asht edhe fakti se në përgjithësi këto organe; me ndryshime të vogla, patën tirazh të ulët. Megjithatë, nga të dhanat e derisotme, rezulton se mbrenda dhe jashtë janë botue deri më 1944 mbi 400 gazeta dhe të përkohëshme të ndryshme.

L'Albanese d'Italia (Shqiptari i Italisë), që nxori në Napoli në vjetin 1848 patrioti i madh arbënesh, Jeronim De Rada, konsiderohet si e para gazetë shqiptare³⁰⁾. Kjo gazetë pat në jetë të shkurtë. 12 vjet mbas gazetës së De Radës, më 1860 në Lamia të Greqisë u botue në gjuhën greke dhe pjesërisht shqipe e përjavëshmja *Pellagos* e drejtueme nga A.I. Biku (Piqueu). Kjo gazetë përmban, ndër të tjera, edhe një numër artikujsh me interes për gjuhësinë shqiptare (artikuj për alfabetin, etimologjinë e gjuhës shqipe, etj. *) Më 1879, u botuen edhe dy gazeta të tjera: njena në Athinë, nga arbëneshi i Greqisë, Anastas Kullurioti me titull "Η Φωνή της Ἀλβανίας", (Zani i Shqipnisë) (1879-1880) dhe tjera, për të cilën u ba fjalë këto

*) Këtë informatë pati mirësinë të na e jepte. Prof. A. Buda, i cili e zbuloi këtë gazetë me rastin e një vizite që bani në Greçi kohët e fundit.

kohët e fundit⁸¹⁾, u botue në Shkodër në gjuhët shqip-turqisht, si organ i vilajetit të këtij qyteti, me titull "Ishkodra" (1879-1897).

Koleksionet e këtyne gazetave, veç ndonjë numri të shkëputun, për fat të keq nuk patëm rasë t'i shohim, kështuqë vjelja e të dhanave për këtë punim nisi me revistën e mirënjohun të J. De Radës, *Fiāmuri Arbërit* (La Bandiera dell'Albania). Kjo revistë u botue për tri vjet me radhë, së pari në Koriliano Kalabro dhe ma vonë në Kozenca (Itali), prej datës 20 korrik 1883 e deri me 15 nandor 1887.

Përsa i përket shtypit shqiptar (të botuem mbrenda dhe jashtë) mund të thuhet me siguri se fondi ma i pasun në botë sot ndodhet në Shqipëri. Dhe kjo asht një meritë e interesimit të vazhdueshëm të bibliotekave tona, veçanërisht e Bibliotekës Kombëtare të Tiranës dhe e Bibliotekës Shkencore të U.S.H.T., të cilat kanë mundun të grumbullojnë një fond mjaft të pasun të shtypit tonë. Bibliotekave tona u mbetet ende mjaft punë për të ba në këtë drejtim. Në fondin e shtypit të këtyne bibliotekave ka ende mungesa faqesh, numrash e vjetesh të tana, pa përmendun edhe mjaft tituj organesh që mungojnë fare.

Sikurse çdo punim bibliografik ndërtohet në bazë të disa kritereve të caktueme që në fillim, edhe ky punim ka ndjekun disa kritere, ma kryesoret e të cilave, janë këto:

1) Gjatë vjeljes së shtypit, pamvarësisht nëse autori i shkrimit asht specialist i landës apo diletant i thjeshtë, u nxuer çdo gja që drejtpërdrejt ose tërthorazi paraqet ndonjë interes, qoftë edhe të vogël, për gjuhësinë, siç janë p.sh. artikujt ose të dhanat e tjera në lidhje me alfabetin e gjuhës shqipe, me atlantet gjuhësore, me dialektet, etimologjinë, fjalorët e fjalorthët, fonetikën, frazeologjinë, gramatikën, gjenezën e gjuhës, gjuhën letrare kombëtare, leksikon, neologjizat, ortografinë, pastërtinë e gjuhës shqipe, etj. Në këtë punim, veç të dhanave që përmendëm ma nalt, janë përfshi edhe të tjera, të cilat, në kuptimin e ngushtë të fjalës, i kapërcejnë interesat thjesht gjuhësore. Të tillë janë p.sh. artikujt ose të dhanat mbi autorët e vjetër (deri shek. XVIII), onomastikën- (antroponiminë e toponiminë), etnogjenezën, informata e njoftime biografike për albanologë të huej a vendas, bibliografitë, institutet, shkollat, katedrat e kurset e gjuhës shqipe jashtë Shqipërisë, kongreset gjuhësore, konferencat, klubet e shoqitë për përhapjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, njoftimet, lajmet, udhëzimet recensionet, polemikat, kuriozitetet gjuhësore, etj. etj.

2) Meqënëse shpeshherë autorë të ndryshëm shkruajnë në një artikull të vetëm për disa çeshtje bashkë: për alfabetin, ortografinë, etimologjinë, gjuhën letrare, etj., ndërtimi i këtij punimi, për lehtësi shfrytëzimi ma shumë se nga një anë, u ba në bazë të kronologjisë (tue fillue nga vjeti 1883 e tue shkue deri më 1944), me renditje alfabetike mbrenda çdo vjeti, në bazë të shkronjës së parë të mbiemrit të autorit, të pseudonimit dhe, kur mungojnë këto, të titullit të artikullit.

3) Vjela dhe përpunimi i të gjitha zaneve të këtij punimi, asht ba *de visu*, drejtpërdrejt nga teksti, pa referime marrë prej dore së dytë.

4) Përshkrimi i titujve, autorëve dhe i të dhanave të tjera, kur janë me shkronja latine, asht ba simbas origjinalit, tue ruajtun alfabetin dhe ortografinë e tekstit.

5) Titujt me shkronja greke, turke, sllave ose të përcieme si p.sh. alfabeti i Shoq. së Stambollit etj. janë kthye në alfabetin latin.*)

6) Për artikujt pa nënshkrim, kur ka qenë e mundun të dihet emni i autorit, emni i tij asht vu në kllapa katrore; gjithashtu edhe për një numur pseudonimesh, kur jemi sigurue mirë, kemi vu në kllapa emnin e vërtetë. Rasat e dyshimta ose të panjohuna i kemi lanë ashtu siç janë.

7) Për të gjithë artikujt, me përjashtime të rralla, kur titulli flet vetë për përmbajtjen, janë dhanë shënime përmbledhëse të përmbajtjes kryesore ose të pjesëshme, simbas interesit që paraqet për gjuhësinë.

8) Titujt e artikujve në gjuhë të hueja janë dhanë edhe në përkthimin shqip, në kllapa katrore.

9) Artikujt, që vazhdojnë për dy a ma shumë vjet me radhë, për t'iu shmangë përsëritjes së tyre për çdo vjet, janë grupue në numrin dhe vjetin e parë të daljes së tyre, tue vu në vjetët e mavonshëm vetëm shënimin e referencës.

10) Të gjitha zanet marrin numrin progresiv. Në shtesat që mund t'i bahen ma vonë, në fund të këtij punimi do të shënohet, simbas vjetit dhe rendit alfabetik, fraksioni i numurit përkatës.

11) Emnat e huej (të personave dhe të vendeve) në tekst janë dhanë edhe simbas shqiptimit fonetik të tyre.

Këto janë kriteret që u ndoqën në këtë punim. Një gja që duhet pasun parasysh nga lexuesi, asht edhe kjo: Një numër faktesh, të dhanash e tezash të autorëve të ndryshëm që janë përfshi në këtë punim, për dijen e kohës sonë janë të gabueme ose të diskutueshme ose janë kapërye me kohë dhe sot nuk kanë ndonjë vlerë shkencore. Analiza kritike e tyre asht një objekt pune më vehte. Çëllimi i këtij punimi modest (i cili përmbledh në vetvete mendimin

*) Kthimin në alfabetin latin u detyruem ta bajmë për shkak se shtypshkronja nuk disponon disa shkronja të alfabeteve të vjetra, jo latine. (Sh. i A.)

shqiptar dhe të huej, të pasqyruem në shtypin e ma se 60 vjetëve për çeshtje të ndryshme të gjuhësisë) asht, në radhë të parë, t'u japë punonjësve shkencorë, pedagogëve, mësuesve, studentëve, bibliografëve dhe gjithë atyne që kanë interesa për studime gjuhësore, një grumbull faktesh e të dhanash të panjohuna për të gjithë, së dyti, të kontribuojë në hartimin e një bibliografie gjuhësore të plotë.

Për ta ba ma të lehtë dhe praktikisht ma të përdorshëm këtë punim, në fund do të jepem edhe këto pasqyra: 1) indeksi alfabetik i personave (autor ose jo) që përmenden në këtë punim 2) tabela analitike, simba landës, me referime të numri përkatës, 3) lista e plotë e shtypit, që u shfrytëzue në këtë punim, me të dhana edhe për vendin ku gjinden.

*

Tue i mbyllun këto radhë, përfitojmë nga rasti të falënderojmë drejtuesit e Bibliotekës Kombëtare dhe të Bibliotekës Shkencore të U.S.H.T. si dhe punonjësit respektivë të sektorëve të bibliografisë edhe të albanologjisë, Arkivin e Shtetit të R.P.SH. dhe Bibliotekat e Shtetit në Korçë, Elbasan e Shkodër për ndihmën dhe lehtësinat që na dhanë sidomos në shfrytëzimin e koleksioneve të shtypit.

Në mënyrë të posaçme falënderojmë shokun Androkli Kostallari, i cili na ngarkoi këtë punë tue mos u kursye të na ndihmojë prej disa vjetsh me vërejtje dhe sugjerime shumë të vlefshme gjithësaherë që u çfaq nevoja. Me vërejtje e sugjerime na ndihmuen edhe prof. A. Krajin e shokë të tjerë të Institutit të Historisë e Gjuhësisë.

Sugjerimet a vërejtjet, me gojë a me shkrim, që do t'i bahen këtij punimi, do të mirëpritën me kënaqësi e mirënjohje dhe do të kihen parasysh në rasën e një botimi të ri të plotësuem

SHENIME

1) A. KOSTALLARI, *Gjendja e studimeve albanologjike në Shqipëri, problemet dhe detyrat e reja*. Buletin i U.S.H.T. Seria Shk. Shoq. Tiranë, XVI/4/1962, fq. 11.

2) po aty, fq. 11-12

3) ALBANISCHE FORSCHUNGEN I. *Die slavischen Elemente im Albanischen*, mit einer Einleitung, welche die Ausbreitung des albanischen Volksstammes, die Quellen unserer Kenntniss der albanischen Sprache, die Laute derselben und die Versuche, diese Laute darzustellen, zum Gegenstande hat. Von Dr. FRANZ MIKLOSICH, Wirklichem Mitgliede der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften. Vorgelegt in der Sitzung am 20. April 1870. WIEN, Aus der Kaiserlich-Königlichen Hof- und Staatsdruckerei. In Commission bei Karl Gerold's Sohn, Buchhändler der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, 1870, (Separatdruck aus dem XIX. Bande der Denkschriften der philosophisch-historischen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften) fq. 38 (Bibliografia f. 3-9). [GJURMIME SHQIPTARE I. *Elemente slave në gjuhën shqipe*, . . . nga Dr. Franz Miklosich, Vienë, 1870.] / Gjendet në Bibliotekën Kombëtare, Tiranë, Nr. 79a — A-25/1.

4) JUP KASTRATI, në: *Historiku i bibliografisë shqipe*, botue në Buletin i U.S.H.T., Seria Shk. Shoq. Tiranë, 1957, XI/1, 225-230, ribotue me plotësim edhe në veprën *Bibliografi Shqipe*, Tiranë, 1959, fq. 9-11, shënon si veprë të parë për bibliografinë shqipe punimin e G. Pétrovich: "Scanderbeg, etj.", botue në Paris më 1881. Punimi bibliografik i Fr. Miklosiçit botue 11 vjet para Pétroviçit (shih shenimin Nr. 3), nuk asht veprë më vechte, po një kapitull. Sikurse e thotë edhe vetë autori, kjo bibliografi i shërbeu si literaturë për studimet e tia shkencore. Ky kapitull mban titullin *Übersicht der Quellen unserer Kenntniss der albanischen Sprache* [Pasqyra e burimeve të njohunive tona rreth gjuhës shqipe]. Përmban 38 vepra me përshkrim të plotë bibliografik, me renditje kronologjike (nis me veprën e F. Bardhit "Dictionarium latino-epiroticum, etj.", 1635 dhe mbaron me "Cuvendi i arbenit" 1868). Për 18 vepra, Miklosiçi jep gjykime e vërejtje të përmbledhuna. Veç veprave që shënon sipër, autori shkruen se ka përdorur në punimin e vet edhe një regjistër me 2000 fjalë, në dorëshkrim, të mblledhuna prej tij nga një gegë në vjetër 40 të shek. XIX, si dhe disa kaugë të mblledhuna nga shqiptarët e Dalmacisë.

5) Π. Α. ΚΟΥΠΙΤΟΡΕΣ, ΑΛΒΑΝΙΚΑ ΜΕΛΕΤΑΙ, ΠΡΑΓΜΑΤΕΙΑ ΙΣΤΟΡΙΚΗ ΚΑΙ ΦΙΛΟΛΟΓΙΚΗ ΠΕΡΙ ΤΗΣ ΓΛΩΣΣΗΣ ΚΑΙ ΤΟΥ ΕΘΝΟΥΣ ΤΩΝ ΑΛΒΑΝΩΝ, ΕΝ ΑΘΗΝΑΙΣ, 1879. (Ekstrakt nga e Përkohëshmjja "Sigramatos", vell. IV, Nr. 1, Athinë mars 1879).. (gjendet në Bib. Komb. me Nr.-80-C-13)

6) GUSTAV MEYER, *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strassburg Verlag von Karl J. Trübner, 1891. "Albanische Bibliographie", f. 516 (Bib. Komb. Nr. 82-D-76).

7) Ing. F. MANEK, Dr. G. PEKMEZI, Ob. Leut. A. STOTZ, *Albanesische Bibliographie*, Wien, 1909, Selbstverlag des Vereines "Dija" VIII, Schmidg. 4/3 Iq. 147 [Bibliographija shqype. E kanë mblledhun Ing. F. Manek, Dr. G. Pekmezi, Ob.-Leut. A. Stotz. Vienë, 1909. E shtypi shoqërija "Dija", VIII — Schmidg. 4/3 (Bib. Komb. 82 — C — 44).

8) (EMILE LEGRAND), *Bibliographie albanaise*. Description raisonnée des ouvrages

publiés en albanais ou relatifs à l'Albanie du quinzième siècle à l'année 1900 par *Emile Legrand*; oeuvre posthume complétée et publiée par *Henri Gôys*, élève diplômé de l'école des langues orientales, Paris, Librairie Universitaire H. Welter, éditeur, 4, rue Bernard-Palissy, 1912, fq. VIII-228. [Përshkrim i arsytetit i veprave të botueme shqip ose në lidhje me Shqipërinë që nga shekulli i pesëmbëdhjetë e deri në vjetin 1900 prej E. Legrand, vepër postume plotësuë e botue prej H. Gyi, nrxanës i diplomuem në shkollën e gjuhëve lindore, Paris, 1912) (Bib. Komb. 84-C-41).

9) Dr. HOLGFR PEDERSEN, *Albanesisch 1909-1912*, Separat. Abdruck aus Band XIII des Romanischen Jahresberichts. Herausgegeben von Karl Volmôller — Erlangen, 1914, fq. I. 251-260. (Bib. Komb. Nr. 80-B-97).

10) (ALBERT THUMB), *Indogermanisches Jahrbuch im Auftrag der Indogermanischen Gesellschaft*. Herausgegeben von Albert Thumb und Wilhelm Streitberg I. Band Jahrgang 1913, Strassburg, Karl J. Trübner, 1914, fq. 80-82; II. Band Jahrgang 1914 Strassburg, 1915, fq. 71-72; III Band Jahrgang 1915, Strassburg, 1916, fq. 58-60 [Vjetari indogerman hartue me porosi të Shqonisë indogermane. Botue nga Albert Thumb dhe Vilhelm Shtrajtberg, vëllimi I i vjetit 1913 Shtrasburg, 1914, fq. 80-82, vv.1 (Bib. Univ. Shtet. Nr. 4/J-428 (1-3)).

11) NORBERT JOKL, *Indogermanisches Jahrbuch*, etj. IV. Band Jahrgang, 1916 Strassburg, 1917 — VII. *Albanisch*, fq. 100-111; V. Band Jahrgang 1917 Strassburg, 1918 — VII. *Albanisch*, fq. 95-113; VI. Band Jahrgang 1918 Berlin W. 10 un+ Leipzig, 1920 — VII. *Albanisch*, fq. 71-86; VIII Band Jahrgang 1920/21, Berlin und Leipzig, 1922 — VII *Albanisch* fq. 71-94; IX. Band Jahrgang 1922/23, Berlin und Leipzig, 1924 — VII. *Albanisch*, fq. 62-79; X. Band Jahrgang 1924/25, Berlin und Leipzig, 1926 — VII, *Albanisch*, fq. 152-190; XI. Band Jahrgang 1926/27 (Bibliographie des Jahres 1924/25), Berlin und Leipzig, 1927 — VII *Albanisch*, fq. 180-244; XII. Band Jahrgang 1928 (Bibliographie des Jahres 1926), Berlin und Leipzig, 1928 — VII. *Albanisch*, fq. 104-158; XIII. Band Jahrgang 1929 (Bibliographie des Jahres 1927), Berlin und Leipzig, 1929 — VII. *Albanisch*, fq. 140-194; XIV. Band Jahrgang 1930 (Bibliographie des Jahres 1928), Berlin und Leipzig, 1930 — VII, *Albanisch*, fq. 82-139; XV. Band Jahrgang 1931 (Bibliographie des Jahres 1929), Berlin und Leipzig, 1931 — VII. *Albanisch*, fq. 173-207; XVI. Band Jahrgang 1932 (Bibliographie des Jahres 1930), Berlin und Leipzig, 1932 — VII. *Albanisch*, fq. 146-179; XVII. Band Jahrgang 1933 (Bibliographie des Jahres 1931), Berlin und Leipzig, 1933 — VII. *Albanisch*, fq. 138-174; XVIII. Band Jahrgang 1934 (Bibliographie des Jahres 1932), Berlin und Leipzig, 1934 — VII. *Albanisch*, fq. 122-164; XIX. Band Jahrgang 1935 (Bibliographie des Jahres 1933), Berlin und Leipzig, 1935 — VII. *Albanisch*, fq. 125-160; XX. Band Jahrgang 1936 (Bibliographie des Jahres 1934), Berlin und Leipzig, 1936 — VII. *Albanisch*, fq. 129-158; XXI. Band Jahrgang 1937 (Bibliographie des Jahres 1935), Berlin und Leipzig, 1937 — VII. *Albanisch*, fq. 202-235; XXII. Band Jahrgang 1938 (Bibliographie des Jahres 1936), Berlin, 1938, — VII, *Albanisch*, fq. 169-213; XXIII. Band Jahrgang 1939 (Bibliographie des Jahres 1937), Berlin, 1939 — VII. *Albanisch*, fq. 202-247; XXIV. Band Jahrgang 1940 (Bibliographie des Jahres 1938), Berlin, 1940 — VII. *Albanisch*, fq. 209-266. — (Bib. Univ. Shtet. Nr. 4/I—428 (4-26))

12. LUDWIG BÜRCHNER, ΔΟΚΙΜΙΟΝ ΒΙΒΛΙΟΓΡΑΦΙΚΟΝ ΠΕΡΙ ΤΩΝ ΗΠΕΙΡΟΥ ΚΑΤΑ ΤΟΥΣ ΝΕΩΤΕΡΟΥΣ ΧΡΟΝΟΥΣ ΔΗΜΟΣΙΕΥΘΕΝΤΩΝ botue në «ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΑ ΧΡΟΝΙΚΑ» ΕΝ ΙΩΑΝΝΙΝΟΙΣ, 1926, ΕΤΟΣ ΠΡΩΤΟΝ fq. 7-38. (Bib. Komb. Nr. 86 —C—1 (1).

13. (L. SKENDO) *Bibliografi Shqiptare*. "Shtim në radhøj i Emile Legrandit" botue në rev. *Diturija*, Tiranë, vol. II (1926), fq. 37-39, 76-79, 193-200, 233-238, 313-320, 346-356, 393-397, vol. III (1927) fq. 36-40, 72-79, 115-119, 158-160, 194-196, 234-240, 274-278, 318-320 350-356, 393-400 (1928), 79-80, 197, 279, 356-360, vol. IV (1929) 35-40, 78, 79, 111-115. / Bib. Komb. S1-F-8 (1-3).

14. PER. K. ΒΙΖΟΥΚΙΔΟΥ, ΣΥΜΒΟΛΑΙ ΕΙΣ ΤΗΝ ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΗΝ ΒΙΒΛΙΟΓΡΑΦΙΑΝ, në «ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΑ ΧΡΟΝΙΚΑ» ΕΝ ΙΩΑΝΝΙΝΟΙΣ 1927 ΕΤΟΣ ΔΕΥΤΕΡΟΝ, fq. 110-126 dhe ΕΓΟΣ ΤΡΙΤΟΝ, 1928, fq. 103-116 (Bib. Komb 86 — C — 1 (1-24)

15. N. BEES, ΣΥΜΒΟΛΑΙ ΕΙΣ ΤΗΝ ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΗΝ ΒΙΒΛΙΟΓΡΑΦΙΑΝ, në «ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΑ ΧΡΟΝΙΚΑ» ΕΝ ΙΩΑΝΝΙΝΟΙΣ, 1927, fq. 127-147, 152. (Bib. Komb. 86-C-1 (1-24).

16. — D.P. ΚΑΛΟΓΕΡΟΠΟΥΛΟΥ, ΒΙΒΛΙΟΓΡΑΦΙΚΗ ΣΥΜΒΟΛΗ ΕΙΣ ΤΑ ΠΕΡΙ ΑΛΒΑΝΙΑΣ (1771—1929.) ΑΘΗΝΑΙ, 1929 fq. 22. /Bib. Komb. 87-E-5).

17. — ΕΥ. ΚΟΥΡΙΛΑ, ΒΙΒΛΙΟΓΡΑΦΙΑ ΗΠΕΙΡΟΥ ΚΑΙ ΑΛΒΑΝΙΑΣ (ΣΥΜΠΛΗΡΩΜΑ ΤΩΝ ΥΠΟ ΛΕΓΡΑΝΔ, ΒΥΡΧΗΡ, ΒΙΖΟΥΚΙΔΟΥ ΚΑΙ ΒΕΕΣ ΕΚΔΟΘΕΙΣ ΔΕΥΤΕΡΟΝ) në «ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΑ ΧΡΟΝΙΚΑ» ΕΝ ΙΩΑΝΝΙΝΟΙΣ, 1928. ΕΤΟΣ ΤΡΙΤΟΝ fq. 50-102, ΕΤΟΣ ΤΕΤΑΡΤΟΝ, 1929 fq. 112-145, ΕΤΟΣ ΠΕΜΠΤΟΝ, 1930, fq. 119-152, 236, 252; ΕΤΟΣ ΕΚΤΟΝ, 1931 fq. 75-153. (Plotësim i botimeve të bame nga Legrand, Burchner, Vizukides e Bees në "Kronikat Epirote" Janinë, 1928, Vjeti i tretë, fq. 50-102; Vjeti i katërt. 1929, fq. 112-145, vjeti i pestë, 1930, fq. 119-152; 236-252; vjeti i gjashtë, 1931, fq. 75-153), (Bib. Komb. Nr. 86-C-1 1-24).

18. B. A. MYSTAKIDES, ΣΥΜΒΟΛΗ ΕΙΣ ΤΗΝ ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΗΝ ΒΙΒΛΙΟΓΡΑΦΙΑΝ
në "ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΑ ΧΡΟΝΙΚΑ. ΕΝ ΙΩΑΝΝΙΝΟΙΣ, 1931, ΕΤΟΣ ΕΚΤΟΝ fq 227-284.
(Bib. Komb. Nr. 86-C-1 (1-24).

19. Prof. PAPAS GAETANO PETROTTA, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Tipografia Pontificia — Palermo, 1931 "Bibliografia" fq. XVII-LIV, dhe *Saggio di bibliografia albanese* (1500-1930), Palermo, 1931, fq. 40 (Bib. Komb. nr. 81-D-64).

20. Π. Η. ΜΙΧΑΛΟΠΟΥΛΟΣ, ΣΥΜΒΟΛΗ ΕΙΣ ΤΗΝ ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΗ ΒΙΒΛΙΟΓΡΑΦΙΑΝ
në «ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΑ ΧΡΟΝΙΚΑ» ΕΝ ΙΩΑΝΝΙΝΟΙΣ, 1932 ΕΤΟΣ ΕΒΔΟΜΟΝ
fq. 131-148 (Bib. Komb. Nr. 86-C-1 (1-24).

21. (LÉON SAVADJIAN), *Bibliographie Balkanique 1933* Rédigée par Léon Savadjian, Paris, 1934, *Albanie* fq. 27-29; *Bibl. Balk.* 1936, *Albanie*, f. 29-31, Paris, 1937; *Bibl. Balk.* 1938, *Albanie*, fq. 69-75 (Bib. Komb. Nr. 80-C-54 (1-3).

22. Prof. JEAN G. KERSOPOULOS, *Bibliographie Nr. 1: ALBANIE*. Ouvrages et articles de revues parus de 1555 à 1934. Editions "Flamma", Athènes, 1934, fq. 114 (Extrait de la revue "Les Balkans", Athènes. Série de bibliographie françaises sur les Nations Balkaniques). (Bib. Komb. Nr. 83-C-23).

23. CHALVA BÉRIDZÉ, *Bibliografia Francese dell'Albania*. Napoli, Tip. F. Volpicelli, 1937, fq. 13 (Bib. Komb. Nr. 82-S-44).

24. HENRI GUYS, *Bibliographie Albanaise*. Description raisonnée des ouvrages publiés en Albanie ou relatifs à l'Albanie de 1900 à 1910. Tirana, 1938. Maison éditrice "Kristo Luarasi" fq. 5 + VIII. [Përshkrim i arsytetum i veprave të botueme shqip ose në lidhje me Shqipërinë që nga 1900 deri më 1910] (Bib. Komb. Nr. 83-D-47).

25. CARLO TAGLIAVINI, *Indogermanisches Jahrbuch*, etj. XXV. Band Jahrgang 1941 (Bibliographie des Jahres 1939), Berlin 1942 — VII. *Albanese (e Linguistica balcanica comparata)*, fq. 188-240; (Bib. Komb. Nr. 84-D-2). — *Rassegne bibliografiche "Linguistica"* në "Rivista d'Albania" Roma, 1940, fasc. II, fq. 198-208; fasc. IV, fq. 416-424; 1941, fasc. II, fq. 181-190, fasc. III, fq. 277-285. fasc. IV, fq. 397-413; 1942, fasc. IV, fq. 252-262. (Bib. Komb. Nr. 80-C-18 (1-3).

26. PIERO COSTA, *Bibliografia Albanese*, 1941. Edizione "Distaptr" Tirana, 1942, fq. 65 të shaptillogr. /Bib. Komb. Nr. 81-A-58/.

27. a) Dr. Georg Stadtmüller, Β.βλιογραφία në «ΗΠΕΙΡΩΤΙΚΑ ΧΡΟΝΙΚΑ,» ΕΝ ΙΩΑΝΝΙΝΟΙΣ, 1935, fq. 302-303. (86-C-1 (4).

b) Marco Petta, *Appunti di Bibliografia Albanese*, opere non segnalate nella *Bibliographie Albanaise* de Legrand-Güys e possedute dalla biblioteca Criptense /Ekstrat, gjendet në Bib. Komb. Nr. 91c-C-55/.

c) Katalog 23. BYZANZ Neugriechenland — Albanien Geschichte Literatur, Kunst, Geographie, Zeitschriften. Markert & Petters Leipzig Cl. 13. *Albanien*, fq. 52-56/ Bib. Komb. Nr. 84-C-83/.

ç) Në Архив за арбанаску старину, језик и етнологију, «ЋигаI. Св. 1-2, Београд, 1923, fq. 207, 213, 218, 227, 229 e 231 gjenden shënime bibliografiko-kritike të H. Bariç, P. Skok, Dr. C. Truhelka. (Bib. Komb. Nr. 81-C-128).

d) I do shtue këtyne edhe një numër rubrikash bibliografike të publikueme herë mbas here në shtypin e kohës.

28. Ban përjashtim vetëm shtypin i përditshëm, i cili do të përfshihet kur punimi, mbasi t'i bahen edhe disa plotësime të tjera, të botohet më vehte.

29. Të dhanat bibliografike për shtypin shqiptar që japin autorët e poshtëshënuem, nuk janë të plota: Khs 1) Manek — Dr. G. Pekmezi — A. Stotz, *Verzeichnis der bisher erschienenen albanesischen Zeitungen*, në Bib. Shqype. Vienë, 1909, fq. XI. 2) G. PETROTTA, *Popolo, Lingua e Letteratura Albanese*, Palermo, 1931 — *Stampa periodica* (Riviste e giornali), fq. 402-442); 3) G.S. SPANETTI, *I giornali di lingua albanese stampati in Italia* (ekstrakt), 4) H. GUYS, *Bibliographie albanaise*, Tiranë, 1938—shtypin i viteve 1900—1910; 5) K. GURAKUQI, *Lista e fletoreve shqipe të botueme në Shqipëri 1910-1930*, në "Vullneti i Popullit" Tiranë, 28/XI/1930, fq. 11-12 dhe 6) J. KASTRATI, *Bibliografia shqipe e shtypit* (1848-1946, (dorëshkrim i pabotuem, Arkivi i Inst. Hist. Gjuh.) Shkodër, 1942-1946.

30. "Historia e Letërsisë Shqipe", vëll. II, Tiranë, 1959, fq. 64.

31. Shih. Kr. FRASHËRI, *Në gjurmë të dy gazetave të vjetra shqipe*, "Zëri i Popullit", Nr. 279 (4437), Tiranë, 22-XI-1962, fq. 3.

1883

1. — ALFABETO Albanese [Alfabeti shqip] — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 20 Luglio 1883, Anno I, Nr. 1, fq. 1.*
Në këtë artikull pa nënshkrim, shkruhet se tash e mbrapa, në vend të disa shkronjave greke, do të përdoret alfabeti italian. Jepet një pasqyrë e disa zanoreve dhe bashkëtingëlloreve, dhe mënyra e shqiptimit të tyre.
2. — ANASTAS Culurioti. — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 15 Dicembre 1883, Anno I Nr. 3, fq. 3.*
Njoftohet se konsulli grek në Gjinokastër, arrestoi A. Kulluriotin dhe e dërgoi të shoqnuem në Korfuz. Shkaku i arrestimit asht se A. Kullurioti kishte ardhun në Gjinokastër për të studjue ma për së afërmi gjuhën shqipe.
3. — CALVOSA, M.: Giuseppe De Rada. — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 1 Dicembre 1883, Nr. 3, fq. 1-2.*
Nekrologji për Zef De Radën, të birin e Jeronim De Radës. Në këtë nekrologji, ndër të tjera, thuhet se Zef De Rada hartoi më 1869-70 gramatikën shqipe, e cila u botue në Firence më 1871. Kjo vepër — vazhdon A. — i tërhoqi vëmendjen shumë dijetarëve të huej si Miklosiciti, Majerit, etj. Vetë L. Benlëv, në *Analizën e tij* mbi gjuhën shqipe (Paris, 1879), u mbështet në këtë gramatikë.
4. — CANTO sopra Ibraimin da Ipech. [Kangë për Ibrahimin nga Peja]. *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 30 Settembre 1883, Anno I, Nr. 2, fq. 4-6.*
Botohet një vjershë në gjuhën shqipe, nxjerrë nga vepra e Jubanit, kushtue Ibrahimit nga Peja, Pashë i Shkodrës. Në fund jepen 15 shënime me vërejtje gramatikore e leksikore të tekstit,
5. — LJËPUS nea Jannina (Lettera da Giannina) Szottit N. N. (Al. sig. N.N.). *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 30 Settembre 1883, Anno I, Nr. 2, fq. 6.*
Në këtë letër pa nënshkrim, thuhet se Porta e Naltë e Stambollit, nën nxitjen e grekëve, nuk i jep leje Kristoforidhit të botojë një fjalor shqip-greqisht-italisht dhe turqisht, të cilin autori e ka gati prej kohësh.

1884

6. — [ALFABETAREJA]. — *DRITA Konstantinopole, 10 te sieshtese dyte, 1884, Viti I, Nr. 3, fq. 47.*
"Me të qënë që ca nga këndonjësit' e kësaj fletore — shkruen Red. — edhe s'e kanë mësuarë mirë zën'e sicilësëdo nga shkronjatë shqip, ja se ku i tregojmë me frengjisht, a italisht, edhe me greqisht". Ma poshtë jepet një pasqyrë e alfabetit të shqipes më 36 shkronja. Të gjithë tingujt jepen me nga një shkronjë të vetme.
7. — ARËBREST (T') e Calabries (Gli albanesi di Calabria). — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 15 Gennaio 1884, Anno I, Nr. 4, fq. 3-8.*
Në faqen 7-8 gjindet një shënim mbi ortografinë dhe përdorimin e shkronjës ë.
8. — COLLEGI i Arbres (Il Collegio Albanese). — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 15 Febbraio 1884, Anno I, Nr. 5, fq. 2-5 (vv).*
Në faqen 2-3 në shënim flitet për prapashtesat shqipe zogëluese e përkëdhelëse
th e z: Szot (signore) Szotëth, gchrep (forchetta) gchrepëth; tek foljet dhe emna që mbarojnë me l, lj, r të primun nga i: rjan (guarda) ruanen (guardano), ruanith, ruanënth; diaalj (fanciullo) diaaljith; diel (sole) dielith; ajer (vento) ajërith. Vasa (giovanetta) vasa-sz, delje (pecora) delje-sz, etj.
9. — DARA, Cav. GABRIELE; Monografii e Palaz-Adrianit (Monografia di Palazzo Adriano). — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 30 Aprile 1884, Anno I, Nr. 7, fq. 5-8.*
Pëmban edhe antroponime (emna fishes të familjeve arbneshe): Barci, Bëljucci (Belucci), Bardhusi (Bardhusci), Vacula, Burrësa, Crepsi, Camizzi, Costantini, Caljavai (Cagliavai), Conti, Barbati, Cukji (Cucci), Ljëcureszi (Licursi), Rafti (Rafsi) Ljësi (Ljesci), Prifti, Mazzarakji, Markjanji, Proffera, Scariani, Dragoti, Glaviani, Cialja, Pokjini, Sulji, Prawata, Sirgji, Despoti, Spata, Skirëi, Vranai, Zincana, etj.
10. — LAIJM' I Atti-Parthina (Notizia recentissima). — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 30 Maggio 1884, Anno I, Nr. 8 fq. 8.*

Athinë më 10 qershor: Njoftohet se në Institutin filologjik të Parnasit në Greqi, u krijue shoqnia "Vëllaznit Shqiptarë", në statutin e së cilës, ndër të tjera, thuhet se shoqnia ka për qëllim përhapjen, naltësimin e pastrimin e gjuhës shqipe.

11. — MITKO, EUTIMIO: Topografi e Corcës (Topografia di Korizza). — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell' Albania) Corigliano Calabro, 30 Giugno 1884, Anno I, Nr. 9, fq. 6-8 dhe Nr. 10 fq. 7-8.*
Përmban edhe toponime të krahinës së Korçës dhe të zonave përreth saj.
12. — MUSACHIA, PAPAS GIUSEPPE: Monografia di Piana de'Greci. — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell' Albania) Corigliano Calabro, 30 Ottobre 1884 Anno I, Nr. 12, fq. 5-8 (op.).*
Përmban edhe onomastikë (antroponime të shek. XV).
13. — TRII fiaal t'Arhërësa AT, EEM e SIS (Tre parole albanesi AT, EEM e SIS). — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 30 Maggio 1884, Anno, I, Nr. 8, fq. 7 e 8.*
Etimologji e gramatikë.

1885

14. — DOCHI, PRIMO: Topografia d'Alessio in Albania [Topografia e Lezhës në Shqipni] *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 20 Ottobre 1885, Anno II, 6,7, fq. 7-8*
Përmban edhe të dhana mbi antroponiminë e toponiminë.
15. — MUSACCHIA, Dott. GIOVANNI: Monografia di Ururi [Monografia e Ururit]. *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 20 Giugno 1885, Anno II, Nr. 3, fq. 6-8 dhe Nr. 4, fq. 7-8.*
Përmban edhe të dhana mbi antroponiminë e toponiminë e Ururit (krahinë e popullueme prej arbëneshvet).
16. — PELASGI ed Elleni [Pellazgë dhe Helenë]. — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 20 Settembre 1885, Anno II, Nr. 5, fq. 3-8.*
Përpjekje për të provue prejardhjen e shqiptarëve nga pellazgët. Në shënime jepet edhe një ekstrakt i studimit të L. Pordhoszkyt "Suffixes verbaux albanais tirés du chant de Milosao" [Mbrapashtesat foljore shqipe nxjerrë nga kënga e Milosaos].
17. — PODHORSZKY, LUDVIG: [Një letër]. — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Corigliano Calabro, 10 Aprile 1885, Anno II, Nr. 1, fq. 8.*
Botohet letra e Louis Podhorskyt, i akademisë hungareze, me të cilën përcjellë një studim të tijin mbi identitetin e mbrapashtesavet shqipe. latine e finlandeze. Ky studim, shkruhet, do të botohet në këtë revistë.
18. — RILIEVI grammaticali della lingua albanese [Relieve gramatikore të gjuhës shqipe]. — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Cosenza, 20 Novembre 1885, Anno II, Nr. 7, fq. 7-8; dhe 20 Gennaio 1886, Anno III, Nr. 9, fq. 8, Nr. 11 fq. 7.*
Pasqyrë e lakimit të emnave shqipe në shqip e italisht me shënime. Emna të shquem (nomi determinativi), etj.

1886

19. — AIFABETO allanese [Alfabeti shqip]. — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania), Cosenza, 15 Ottobre 1886, Anno III, Nr. 1, fq. 1.*
Riprodhim i artikullit të botuem në këtë të përkohëshme, Vjete I, Nr. 1, fq. 1, 1883. (Shih Nr.1).
20. — FRIIN ajer i miir (Spira buon vento).—*FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell' Albania), Cosenza 15 Novembre 1886, Anno III, Nr. 2, fq. 5-6.*
Njoftohet se u hap i riorganizuem në gjimnaz e lice Kolegji Arbënesh i Shën Mitrit. Ftohen shqiptarët me i dërgue fëmijet e tyne ma mirë me studjue në këtë shkollë shqipe, scsa në shkollat e hueja greke e franceze.

21. — MITKO, EUTIMIO: Vestigia delle antiche nostre sedi, che durano tra noi [Gjurma të vendbanimeve tona të lashta, që vazhdojnë te ne]. — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Cosenza, 20 Aprile 1886, Anno III, Nr. 12, fq. 8 dhe Anno III, 1887, Nr. 5, fq. 1-4 ; Nr. 7, fq. 5-7.*
Përmban emna topikë të Shqipnisë Jugore dhe të Mesme, që i pëgjigjen antropo-nimeve arbëneshe ; jepen edhe një numur toponimesh, disa prej tyre, me shpjegime etimologjike.
22. — (PODHORSZKY, L.): Progressi nella classificazione della lingua albanese [Përparime në klasifikimin e gjuhës shqipe]. — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Cosenza, 15 Novembre 1886, Anno III, Nr. 2, fq. 8.*
Botohet letra frengjisht e linguistit L. Podhorszky, i cili, ndër të tjera ; i shkruen revistës se po i dërgon një studim mjaft voluminoz, në dorëshkrim, mbi afërsinë e shqipes me keltishten. "Ajo që do t'ju çuditë ma shumë — shkruen Podhorszky — asht afërsia me gjuhën egjyptiane, e cila ka — me gjuhën kelte — po atë formin leksikologjik", etj.
23. — RELIEVI Grammaticali... Shih Nr. 18 (1885).

1 8 8 7

24. — LAIJE cheso-ditteshim (Notizie recenti). — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Cosenza, 15 Marzo 1887, Anno III, Nr. 3, fq. 6-7.*
Nga kjo rubrikë nxorëm këtë shënim :
— Vdiq Anastas Kullurioti, i cili shkroi shumë për gjuhën shqipe, etj.
25. LUVDIG Podhorsky. — *FIAMURI ARBËRIT (La Bandiera dell'Albania) Cosenza, 15 Novembre 1887, Anno III, Nr. 7, fq. 8. (ov).*
Të dhana biografike mbi L. Podhorskya, linguist dhe anëtar i Akademisë hunga-reze të shkencave.
26. — MITKO, EUTIMIO : Vestigia delle antiche nostre sedi... Shih Nr. 21 (1886).

1 8 9 6

27. — ALFABETO albanese [Alfabeti shqip]. — *ILI I ARBRESVET (La Stella degli Albanesi) Corigliano Calabro, 1 agosto 1895, Anno I, Nr. 1, fq. 12.*
Jepet një pasqyrë e plotë e alfabetit të shqipes (të arbënesheve) me shpjegime, adoptue pas veprës së De Radës dhe aprovue në Kongresin e parë gjuhësor (1895).
28. — BILOTTA, B. : Psicologia della lingua albanese [Psikologji e gjuhës shqipe]. — *ILI I ARBRESVET (La Stella degli Albanesi) Corigliano Calabro, 30 settembre 1895, Anno I, Nr. 2, fq. 26.*
Përpyekje etimologjike.
29. — CONGRESSO Linguistico-Albanese [Kongres gjuhësor-shqiptar]. — *ILI I ARBRESVET (La Stella degli Albanesi) Corigliano Calabro, 1 agosto 1895, Anno I, Nr. 1, fq. 3-8.*
Kronikë mbi punimet e Kongresit të parë gjuhësor shqiptar, mbajtur në Koriniano Kalabro më 1-3 tetor 1895 nën kryesinë e J. De Radës. Në këtë kongres u muerën këto vendime : 1) u aprovua alfabeti i adoptuem më 1894 nga De Radës ; 2) U krijue një komision prej 14 vetësh për hartimin e fjalorit të gjuhës shqipe ; 3) U themelue Shoqata Kombëtare Shqiptare dhe u aprovue statuti i saj ; 4) U vendos të botohet një revistë italo-shqiptare "Ili i Arbresvet" nën drejtimin e A. Argondizza, etj.
30. — DIREZIONE (LA) : Dizionario Albanese [Drejtimi: Fjalori shqip]. — *ILI I ARBRESVET (La Stella degli Albanesi) Corigliano Calabro, 1 agosto 1896, Anno, I, Nr. 1, fq. 6.*
Në Kongresin e parë gjuhësor u muar një vendim për hartimin e fjalorit të gjuhës shqipe. Drejtimi kritikon metodën që ndiqet në hartimin e këtij fjalori, dmth.

- që çdo shkronjë ta punojë një njeri. Propozohet të Lotohen herë mbas here në shtyllat e kësaj fletoreje shkronjat e përfundume, etj.
31. — DIREZIONE (LA) : Relazioni con la Madre Patria [Lidhjet me Atdeun Nanë]. — *ILI I ARBRESVET (La Stella degli Albanesi) Corigliano Calabro, 30 settembre 1896, Anno I, Nr. 2, fq. 20-23.*
Një nga argumentat e lidhjeve të dobëta në mes të Kolonive arbëneshe dhe Shqipnisë—shkrues Drejtimi — asht edhe mungesa e një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe për të dy anët, etj.

I 8 9 7

32. — ALFABETI. — *SHQIPERIA Bucuresci, 17 të Mait [1897], Vit parë, N. 2, fq. 1.*
Njoftohet se alfabeti, që do të përdorë kjo e përkohëshme, do të jetë me shkronja latine.
33. — ANASTAS Kulturioti. — *SHQIPERIA Bucuresci, 15 Noembrit 1897, Vit i parë, No. 4, fq. 3-4.*
Të dhana biografike mbi jetën dhe veprat e A. Kulturiotit.
34. — ARCONIZZA, ANTONIO : All'ora di andare in macchina [Në minutin e fundit të vajtes në shtyp]. — *ILI I ARBRESVET (La Stella degli Albanesi) Corigliano Calabro, 31 Gennaio, 1897 Anno I, Nr. 3, fq. 47-48.*
Botohet vendimi i Kryesisë së Shoqatës Kompletare Shqiptare (Società Nazionale Albanese), ku u bahet e ditun anëtarëve të shoqatës, se kongresi i dytë gjuhësor shqiptar, do të mbahet në Lungro, më 20 shkurt 1897. Ma poshtë A. e kritikon këtë vendim si jo të drejtë për disa çështje, për të cilat nuk asht i një mendjeje me autorët e vendimit.
35. — BARCIA, Prof. GIGVANNI : Gli Istituti Italo-Albanesi [Institutet Italo-Shqiptare]. — *LA NAZIONE ALBANESE Pallagorio (Catanzaro), 1 Giugno 1897, Anno I, No. 10, fq. 4-5.*
A. propozon shkrimjen e të gjitha shkollave dhe kolegjeve arbëneshe në një institut qëndror, i cili do të marrë emrin "Institutit i Madh i Italo-Shqiptarëve". Shton se për funksionimin e këtij instituti, duhet të hartohet statuti, rregulloja etj.
36. — BENLOEW, LOUIS : I Albaniki Glossa [Gjuha shqipe]. — *SHQIPERIA Bucuresci, 22 të Mait (1897), Vit parë, Nr. 3, fq. 2-3.*
Artikull kushtue gjuhës shqipe, shkruar greqisht.
37. — BENLOEW, L. : [Letër]. — *LA NAZIONE ALBANESE Pallagorio (Catanzaro), 15 Novembre 1897, Anno I, Nr. 22, fq. 7-8.*
Letër frengjisht e L. Benlëv, dërgue A. Lorekjos. Ndër të tjera, në këtë letër, e njoftun se ka me e vu në dijeni të punimeve të Kongresit Orientalist, që u mbajt në Paris. Që shqipja të bahet ma e njoftun në Francë, Itali e njeti, vazhdon Benlëv, duhet të shtypet një fjalor i plotë i gjuhës shqipe, një manual për udhëtarët që vinë nga larg, etj.
38. — (BENLOEW, L.) : Në kartë é Z... — *SHQIPERIA Bucuresci, 15 Noembrit 1897, Vit i parë, Nr. 28, fq. 5.*
Ribotim i letrës që L. Benlëv i dërgoi A. Lorekjos, botue në *La Naz. Alb.* 1897; I, 22, fq. 7-8. (Shih *Nr. 37*).
39. — [BENLOEW, LOUIS] : Per Alfabetnë. — *SHQIPERIA Bucuresci, 5 të Korhikut 1897, Vit i parë Nr. 9, fq. 5.*
Botohet një letër e L. Benlëv, me të cilën fton Shqiptarët që të përdorin alfabetin latin, ashtu siç veproi edhe Jakob Grimm i për gjermanishten, i cili vendosi shkronjat latine. Ma poshtë red. në një shënim të sajën, njoftun mbi disa ndryshime të vogla që i ban alfabetit, që përdor kjo e përkohëshme.
40. — BENLOEW, L. : Philologie et Politique : Un detracteur des Albanais et leur delegué [Filologji e Politikë : Një shpifës kundër Shqiptarëve dhe delegati i tyre]. — *SHQIPERIA Bucuresci, 29 Noembrit 1897, Vit i parë, Nr. 30, fq. 1-2.*
A. i sillet Oppertit me fjalë të ashpra e fyese tue e quejtun shpifës, etj. për shkak se ky i fundit, ndër të tjera, sipas një citati që sjell vetë Benlëv, ka thanë për shqiptarët se "on ne connaît ni leur origine, ni celle de leur langue, et il faut se délier d'étymologies qui ne represent pas sur un fondement scientifique" Këti pohimi A. i ban një numur pyetjesh.
41. — BIBLIOGRAPHIE. — *ALBANIA (Bruxelles, 1897) I, Nr. 4, fq. 63.*
Recension i shkurtën në frangjisht, me vrejte veprës "Grammatica albanese

- con le poesie rare di Variboba" di Vicenzo Librandi, I vol. in-12 de 198 pp. Prix : 3 francs. Milano, Hoepli, editore.
42. — BILOTTA, B.: Psicologia della Lingua Albanese [Psikologji e gjuhës shqipe]. — *LA NAZIONE ALBANESE Pallagorio (Catanzaro)*, 31 Gennaio 1897, Anno I, Nr. 2 fq. 8 ; Nr. 3, fq. 3 ; Nr. 5, fq. 7-8.
Etimologji. Shumë fjalë të fondit grek e latin, shkruen A., origjinën e kanë nga shqipja. Kështu p.sh. nga fjala *aar*, që A. thotë se asht shqipe, nxjerr një numur derivacionesh në gjuhët greke e latine, etj.
43. — (BRUNIALTI, A.): Computo demografico sulla Shkiperia [Llogari demografike mbi Shqipërinë]. — *LA NAZIONE ALBANESE Pallagorio (Catanzaro)*, 15 Gennaio 1897, Anno I, Nr. 1, fq. 8.
Përmban edhe onomastikë.
44. — (BUCHOLTZ, E.): Critica di Ermanno Bucholtz pubblicata nella *Letteratura Internazionale* di Lipsia su l'operetta di Girolamo De Rada *Pelasgi ed Albanesi* edita in Napoli il 1890. [Kritikë e Herman Bucholtz botue në *Literatura Ndërkombëtare* të Lajpseit mbi vepërën e Jeronim De Radës *Pallazgët dhe Shqiptarët* botue në Napoli më 1890]. — *LA NAZIONE ALBANESE Pallagorio (Catanzaro)*, 1 Giugno 1897, Anno I, Nr. 10, fq. 8 ; Nr. 11, fq. 8 ; Nr. 14, fq. 8.
A. tue i ba një vlerësim në përgjithësi pozitiv vepërës së De Radës, sqaron një numur shpjegimesh etimologjike që De Rada, ka ba në vepërën e vet, etj.
45. — CONGRESSO linguistico [Kongresë gjuhësor]. — *LA NAZIONE ALBANESE Pallagorio (Catanzaro)*, 31 Gennaio 1897, Anno I, Nr. 1, fq. 8.
Njohet se së shpejti do të hapet kongresi i II gjuhësor në Lungro, krahinë e Kozencës. Kongresistët luten të vinë të përgatitun, etj.
